

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-212/14**

**Prishtinë,  
8 Shtator 2016**

Në çështjen juridike të:

**Z.M.B.**

Kliçinë, Pejë

**Pala ankuese**

Kundër

**M.M.**

Darinke Radević 18 2

11250 Železnik,

Čukarica BG, Serbi,

dhe

**V.A.**

Pariska 24/3

IRJM,Shkup

**Palët përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/2014 (lëndët e regjistruar në AKP me

numrat KPA93182 dhe KPA93183), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 8 Shtator 2016, mori këtë:

### AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga Z.M.B. të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-212/2014 dhe GSK-KPA-A-213/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-212/2014.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e Z.M.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/227/2014, të datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA93182 dhe KPA93183.
3. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore KPCC/D/A/227/2014, i datës 13 mars 2014, për sa i përket kërkesave me numrat KPA93182 dhe KPA93183.

#### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 6 tetor 2006, M.M. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë 1) si anëtar i familjes së ngushtë të bartësit të supozuar të së drejtës pronësore – nënës së tij të ndjerë S.M. , ka paraqitur dy kërkesa individuale në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), të regjistruara si lënda nr. KPA13649 dhe lënda nr. KPA13651, ku kërkon ri-posedimin e ngastrës nr. 52 me sipërfaqe prej 1.46.63 Ha dhe ngastrave nr. 49 me sipërfaqe prej 2.77.01 Ha dhe nr. 50 me sipërfaqe prej 00.15.10 Ha, të gjitha këto të ndodhura në zonën kadastrale të Kliçinës, Komuna e Pejës (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar).
2. Më 23 nëntor 2013 motra e palës përgjegjëse në ankesë 1 V.A. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë 2) ishte paraqitur në AKP duke kërkuar të drejtat ligjore mbi  $\frac{1}{4}$  të pjesës ideale të pronës së kërkuar. Ajo nuk e kishte kundërshtuar pjesën ideale të palës përgjegjëse në ankesë 1 dhe shitjen e mundshme të kësaj pjese ndonjë personi tjetër (palës ankuese).
3. AKP e kishte kontaktuar palës përgjegjëse në ankesë 1 më 19 qershor 2013 dhe ai kishte pohuar se kërkesa mund të procedohet duke e konsideruar atë si bashkëpronar me  $\frac{3}{4}$  të pjesëve ideale të pronës së kërkuar. Pala përgjegjëse në ankesë 1 gjithashtu kishte theksuar se ai është duke biseduar me një palë të tretë për shitjen e pronës.

4. AKP kishte bërë ndarjen e kërkesave fillestare dhe kishte krijuar kërkesa të reja në emër të V.A. , domethënë me nr. KPA93182 dhe nr. KPA93183.
5. Gjatë një bisede të mëvonshme më 27 nëntor 2013 pala përgjegjëse në ankesë 1 kishte theksuar se ai ia kishte shitur pjesën e tij ideale të pronës së kërkuar Z.M.B. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) dhe kishte dorëzuar formularin e tërheqjes për kërkesat fillestare.
6. Pala përgjegjëse në ankesë 1 kishte dorëzuar në AKP *inter alia*:
  - Fletën poseduese nr.7 të lëshuar më 16 janar 1992 që paraqet pronën e kërkuar në emër të bartëses të supozuar nga pala përgjegjëse në ankesë 1 të së drejtës pronësore, S.M. , nënës së tij të ndjerë;
  - Certifikatën e vdekjes të lëshuar më 1 shtator 1997 që vërteton se S.M. kishte ndërruar jetë më 30 prill 1991.
  - Certifikatën e lindjes nr.14/1936 që paraqet se nëna e palës përgjegjëse në ankesë 1 është S.M. .
  - Vendimin mbi trashëgiminë nr.133/07 të lëshuar më 06 shkurt 2008 nga Gjykata Komunale në Pejë ku pala përgjegjëse në ankesë 1 është shpallur si trashëgimtar i vetëm i nënës së tij S.M. .
7. AKP kishte siguruar *ex officio* Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.7/2014 ku ceken V.A. dhe M.M. si bashkëpronarë të pronës së kërkuar me  $\frac{1}{4}$  dhe  $\frac{3}{4}$  të pjesëve ideale respektivisht.
8. Të gjithë dokumentet e lartpërmendura ishin verifikuar pozitivisht.
9. Më 13 janar 2013 ishte bërë njoftimi i kërkesave. Prona e kërkuar ishte gjetur e uzurpuar nga Z.M.B. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) i cili kishte marr pjesë në procedurë si palë përgjegjëse në kërkesë duke nënshkruar Njoftimin mbi pjesëmarrjen dhe ku kishte kërkuar të drejtat ligjore mbi pronën e kërkuar.
10. Pala ankuese kishte dorëzuar në AKP këto dokumente:
  - Marrëveshjen e datës 05 dhjetor 2011 në mes të palës përgjegjëse në ankesë 1 në njërën anë si shitës dhe H dhe Z.B. (pala ankuese) në anën tjetër si blerës, për blerjen e  $\frac{3}{4}$  pjesë ideale të pronës së kërkuar.
  - Deklaratën e datës 10 tetor 2012 të palës përgjegjëse në ankesë 1 për shitjen e vullnetshme të  $\frac{3}{4}$  pjesë ideale të pronës së kërkuar për blerësit H dhe Z.B. dhe për marrjen në para të gatshme të çmimit të shitjes.

11. Më 13 mars 2014, KKPK në vendimin e tij KPCC/D/A/227/2014 kishte miratuar kërkesat me arsyetimin se pala përgjegjëse në ankesë 1 e kishte vërtetuar se pala përgjegjëse në ankesë 2 është pronare me  $\frac{1}{4}$  e pjesës ideale të pronës së kërkuar.
12. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 10 qershor 2014. Më 12 qershor 2014 pala ankuese kishte paraqitur ankesa.

### **Pretendimet e palës ankuese**

13. Në ankesat e tij pala ankuese thekson se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe asaj procedurale. Pala ankuese thekson se ai e ka blerë pronën e kërkuar nga palët përgjegjëse në ankesë dhe dorëzoi dokumentet e njëjtë (Marrëveshjen e datës 5 dhjetor 2011 dhe Deklaratën e datës 10 tetor 2012).

### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesave**

14. Ankesat ishin paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe janë të pranueshme.

#### **Bashkimi i ankesave**

15. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parasheh që Gjykata Supreme mund të vendos mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a), Ligji. Ky nen e lejon Gjykatën Supreme të marrë në konsideratë bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtoj dhe marrë vendime kur ka çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
16. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që janë të aplikueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashohin mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin dhe efikasitetin e gjykatës lidhur me lëndën.
17. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën ankesa përkatëse është paraqitur, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë tërësisht të njëjta në të dyja rastet. Vetëm ngastrat, subjekt i të drejtës pronësore e cila

pretendohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.

18. Prandaj ankesat e regjistruara nën GSK-KPA-A-212/14 dhe GSK-KPA-A-213/14 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-212/14.

### **Meritat e ankesës**

19. Pala ankuese kërkon të drejtat ligjore mbi pronën e kërkuar, duke theksuar se ai kishte blerë  $\frac{3}{4}$  pjesë ideale të kësaj prone nga pala përgjegjëse në ankesë 1. Së bashku me ankesën e tij ai ka dorëzuar dokumentet e njëjtë si në procedurën para KKPK-së, që tregojnë se pala ankuese së bashku me një palë të tretë kishte blerë  $\frac{3}{4}$  pjesë ideale të pronës së kërkuar nga pala përgjegjëse në ankesë 1. Blerja ishte konfirmuar nga pala përgjegjëse në ankesë 1. Pala ankuese nuk pretendon dhe dokumentet e dorëzuara nga ai si me përgjigjen në kërkesë ashtu edhe me ankesën nuk paraqesin, asnjë të drejtë ligjore mbi pjesën tjetër prej  $\frac{1}{4}$  pjesë ideale të pronës së kërkuar. Në të njëjtën kohë pala përgjegjëse në ankesë 2 pretendon të drejtat ligjore mbi këtë pjesë ideale  $\frac{1}{4}$  të pronës së kërkuar dhe Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e ka siguruar *ex officio* Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.7/2014 ku përmendet pala përgjegjëse në ankesë 2 si bashkëpronare e pronës së kërkuar me  $\frac{1}{4}$  të pjesëve ideale.
20. Rrjedhimisht, KKPK me të drejtë ka miratuar kërkesat dhe ka njohur të drejtat pronësore të palës përgjegjëse në ankesë 2 mbi pronën e kërkuar. Nuk është bërë as shkelje e së drejtës materiale apo procedurale dhe as nuk ka pasur vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesat janë të pabazuara.
21. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it**